


UDHËZUES
për

Këshillin
Vendor
Rinor
Shijak



Autorë:
Jonida Naska
Blerina Hamzallari

Kontribuesit:
Alisa Peçi
Nadia Guni
Lime Skuka
Klejdi Aliçkolli

© Center for Bridging Communities, tetor 2023
Web.: www.cbc.org.al
Email : info@cbc.org.al



Publikimi i këtij manuali është mbështetur nga
Fondacioni Konrad-Adenauer-Stiftung, Tiranë
Gjetjet, opinionet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura
në këtë udhëzues janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht ato të Fondacionit Konrad Adenauer.



TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	5
Metodologjia.....	7
1- Pjesëmarrja politike dhe sistemet e demokracisë	8
1.1 Çfarë është pjesëmarrja politike e të rinjve?	8
1.2 Tipologjitë e demokracisë dhe strukturat përfaqësuese rinore	10
2- Kuadri ligjor dhe pjesëmarrja politike e të rinjve	16
2.1 E drejta e votës dhe kuadri ligjor	16
2.2 Pjesëmarrja politike e të rinjve	20
3- Këshilli Vendor Rinor Shijak	24
3.1 Problematikat komunitare dhe pjesëmarrja e të rinjve në Bashkinë Shijak.....	27
3.2 Të rinjtë në proceset formale politike dhe angazhimi qytetar	30
4- Skeda pune për Këshillin Vendor Rinor	36
Aneks 1. Barrierat strukturore dhe individuale në përfshirjen e të rinjve në nivel lokal	36

Aneks 2. Vlerësimi i angazhimit të të rinjve në programet për të rinjtë	40
Aneks 3. Instrumenti i rrjetit të qëllimeve.....	49
Aneks 4. Raporti vjetor i punës së Këshillit Vendor Rinor	51
Aneks 5. Formular vetëvlerësimi i punës së Këshillit Vendor Rinor	53
Referencat	55
Shtojcë:	58

HYRJE

Në Republikën e Shqipërisë, angazhimi i të rinjve në proceset politike ka shënuar rënie kryesisht për shkak të humbjes së besimit të të rinjve në politikë. Kuadri ligjor shqiptar përcakton të drejtat sociale, politike, kulturore dhe qytetare të të rinjve. Nga ana tjetër, mungesa e interesimit të të rinjve për pjesëmarrje aktive politike lidhet edhe me informacionin dhe hapësirat e pamjaftueshme të ofruara nga pushteti qendror dhe lokal.

Shumica e raporteve dhe studimeve në Shqipëri analizojnë dinamikën e pjesëmarrjes së të rinjve në sferën politike, por jo ndikimin që mund të kenë në demokracinë e drejtpërdrejtë. Shumë të rinj kanë pikëpamje të ndryshme për çështjet që janë të rëndësishme për ta, por ato shpesh nuk përkthehen në forma të angazhimit politik konvencional dhe jo konvencional. Në kontekstin lokal pjesa më e madhe e grupimeve rinore janë pjesë e forumeve kombëtare apo Këshillave Vendore Rinore dhe shpesh këto struktura janë të varura prej forumeve politike.

Këshilli Vendor Rinor Shijak është një strukturë e re, e ngritur në shtator 2022 dhe në përfundim të një procesi konsultimesh me anëtarët e KVR-së gjatë periudhës Shkurt - Maj 2023 u vlerësua i rëndësishëm hartimi i një udhëzuesi me qëllim rritjen e efektivitetit të punës së KVR-së. Në mbështetje të punës së

bërë nga strukturat rinore të Bashkisë Shijak, ky udhëzues nëpërmjet kombinimit të informacionit teorik dhe aspekteve praktike synon të orientojë dhe lehtësojë proceset e vlerësimit të treguesve të pjesëmarrjes së të rinjve në nivel lokal nga ana e KVR-së.



METODOLOGJIA

Në hartimin e këtij udhëzuesi janë përdorur metoda të kombinuara, cilësore dhe sasiore me qëllim kontrollin e informacionit dhe të dhënave nga burime të ndryshme.

Për të realizuar këtë manual janë përdorur metodat e mëposhtme:

1. Desk review i dokumentave strategjike në nivel qendror dhe vendor, raporteve të institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare mbi pjesëmarrjen politike të të rinjve të lidhura ngushtë me fushën e shoqërisë civile dhe pjesëmarrjes qytetare. Janë përdorur të dhëna dytësore si një rishikim i studimeve ekzistuese, politikave dhe dokumenteve përkatëse me qëllim të eksplorimit të koncepteve bazë dhe instrumenteve ligjore të pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.
2. Fokus grupe me anëtarët e Këshillit Vendor Rinor (KVR) Shijak, në periudhën parazgjedhore Shkurt 2023 – Prill 2023 që kishte për qëllim mbledhjen e informacionit të drejtpërdrejtë lidhur me pjesëmarrjen reale të të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.
3. Pyetësorë me 30 nga anëtarët e KVR-se dhe të rinj të grupmoshës 18 – 29 vjeç në pesë njësitë administrative të Bashkisë Shijak, për të vlerësuar problematikat kryesore lokale, problematikat e lidhura me të rinjtë si dhe angazhimin e tyre qytetar dhe politik.



PJESËMARRJA POLITIKE DHE SISTEMET E DEMOKRACISË

1.1 Çfarë është pjesëmarrja politike e të rinjve?

Pjesëmarrja politike e të rinjve mund të përkufizohet si angazhim aktiv, vullnetar i të rinjve nga perspektiva e tyre qytetare në çdo aktivitet që formëson, prek ose përfshin sferën politike¹. Pjesëmarrja është një e drejtë themelore dhe është një nga parimet drejtuese të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (United Nations, 2017) dallon disa forma të pjesëmarrjes: pjesëmarrjen ekonomike që ka të bëjë me punësimin, eliminimin e varfërisë dhe krijimin e një ekonomie të qëndrueshme; pjesëmarrjen politike që ka të bëjë me qeveritë, politikat publike, ushtrimin e pushtetit dhe ndikimin në shpërndarjen e burimeve në nivele të ndryshme; pjesëmarrjen shoqërore që ka të bëjë me trajtimin e sfidave dhe përfshirjen në jetën e komunitetit vendor; pjesëmarrjen kulturore që ka të bëjë me format e ndryshme të shprehjes dhe të artit (UN, 2017).

1 INSIGHTS – MEANINGFUL YOUTH POLITICAL PARTICIPATION IN EUROPE, Council of Europe and European Commission, 2021

Llojet kryesore të pjesëmarrjes politike:

- **Pjesëmarrja politike konvencionale**

Pjesëmarrja politike konvencionale si përkufizimi minimalist i pjesëmarrjes politike, ndryshe e njohur si “tradicionale” është forma më e vjetër e pjesëmarrjes. Kjo formë përfshin aktivitete të institucionalizuara të tilla si: votimi, pjesëmarrja në zgjedhje ose anëtarësimi në një parti politike (Stockemer 2014).

- **Pjesëmarrja politike jokonvencionale**

Kjo formë e pjesëmarrjes e quajtur edhe “pjesëmarrja joortodokse politike” (Bourne 2010), përfshin aktivitete të tilla që synojnë të ndikojnë në fushën politike, por që kryhen me mjete të ndryshme nga ajo e pjesëmarrjes konvencionale (Galstyan 2019). Në ndryshim nga pjesëmarrja konvencionale politike, ajo mund të përfshijë aktivitete të tilla si protesta, greva, bojkote ose peticione (Quaranta 2012).

- **Pjesëmarrja politike e individualizuar**

Pjesëmarrja politike e individualizuar e quajtur edhe “politika e stilit të jetesës” (de Moor 2016) është pjesë e diskursit të ekspertëve dhe publikut vetëm në dekadat e fundit duke sjellë konceptet kyçe të pjesëmarrjes politike të të rinjve. Ky lloj i pjesëmarrjes politike shpesh zhvillohet në nivel individual dhe si i tillë nuk kërkon veprim grupor, komunitar apo masiv, siç ishte rasti në të dy llojet e pjesëmarrjes politike të përcaktuara më sipër.

Shumë të rinj ndihen të marginalizuar dhe të përjashtuar nga arena politike konvencionale. Për këtë arsye, ata kërkojnë dhe përdorin forma alternative të angazhimit qytetar dhe politik. Në këtë kontekst konsiderohet e rëndësishme të përkufizhen dy format kryesore të angazhimit rinor: angazhimi politik dhe

angazhimi qytetar, të cilat në thelb i shërbejnë njëra-tjetrës dhe përmirësojnë cilësinë e angazhimit të të rinjve.

Angazhim politik zakonisht përdoret për t'iu referuar angazhimit të një individi në institucione politike, procese politike dhe vendimmarrëse.

Angazhim qytetar zakonisht përdoret për t'iu referuar angazhimit të një individi me shqetësimet, interesat dhe të mirën e përbashkët të një komuniteti²

1.2 Tipologjitë e demokracisë dhe strukturat përfaqësuese rinore

Demokracia përgjithësisht përkufizohet si një formë qeverisjeje në të cilën një grupi njerëzish që jetojnë në një territor të caktuar dhe të drejtuar nga ligje të caktuara u jepet dhe një sërë të drejtash për të kontribuar në qeverisjen e vendit (Lundström 2004).

Për të elaboruar më tej demokracinë, eksplorimi i llojeve të mjediseve demokratike që mund të gjenden në klimën aktuale sociopolitike globale është i dobishëm. Para se të shtjellohet çdo lloj mjedisi demokratik, duhet të theksohen specfika të caktuara për të ndihmuar në kuptimin e demokracisë në një kontekst më të gjerë. Përcaktimi i tyre ndihmon për të kuptuar natyrën e një organizimi të caktuar demokratik dhe gjithashtu në identifikimin e aktiviteteve tipike të pjesëmarrjes politike të

2 Martyn Barrett and Dimitra Pachi " Civic and Political Engagement Among Youth" <https://www.taylorfrancis.com/chapters/oa-mono/10.4324/9780429025570-1/civic-political-engagement-among-youth-barrett-martyn-pachi-dimitra?context=ubx&refId=d30215b8-eb62-4e12-bdef-2e1ef6f9bc52>

të rinjve që lidhen me mjedisin e caktuar (Ondřej Bárta & Anna Lavizzari, 2021). Në përgjithësi, njihen pesë lloje mjedisesh demokratike si më poshtë:

- **demokracia e drejtpërdrejtë**

“Demokracia e drejtpërdrejtë” (Linder 2007:1) u mundëson qytetarëve të marrin pjesë drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse duke votuar ose duke nënshkruar peticione detyruese që synojnë arritjen e një qëllimi konkret. Ndërkohë që mund të zhvillohen lloje të ndryshme aktiviteteve, si referendumat, nismat publike apo mbledhjet e Këshillit të Bashkisë (Beedham 2006; Field 2019; Fiorino dhe Ricciuti 2007; Svensson 2007) të cilat janë dhe mjetet më të zakonshme të demokracisë së drejtpërdrejtë.

- **demokracia përfaqësuese**

Në ndryshim nga ideja e demokracisë së drejtpërdrejtë, në rastin e demokracisë përfaqësuese, vendimet nuk merren me votë popullore, por nga përfaqësues të zgjedhur, të cilëve u janë besuar kompetencat vendimmarrëse (Gretschel et al. 2014; Gutiérrez-Peris dhe Margalef 2019 Urbinati dhe Warren 2008). Në mënyrë që një demokraci përfaqësuese të funksionojë, qytetarëve u jepen një sërë të drejtash që përfshijnë por nuk kufizohen në të drejtën e votës dhe të drejtën për të kandiduar për një post.

- **demokracia pjesëmarrëse**

“Demokracia pjesëmarrëse është një proces i vendimmarrjes kolektive që kombinon elementë si nga demokracia e drejtpërdrejtë ashtu edhe nga ajo përfaqësuese: Qytetarët kanë fuqinë të vendosin për politikat dhe politikanët marrin rolin e

zbatuesit të politikave” (Aragonès dhe Sánchez-Pagés 2009: 56). I përshkruar gjithashtu si funksionues në “kryqëzimet ndërmjet institucioneve shtetërore dhe lëvizjeve sociale” (Subirats 2008: 9), qëllimi i demokracisë pjesëmarrëse është që t’i bëjë institucionet demokratike më legjitime dhe të përgjigjen ndaj nevojave të qytetarëve (Subirats 2008). Disa nga mekanizmat konkretë të demokracisë pjesëmarrëse përfshijnë: “buxhetimin me pjesëmarrje, këshillat qytetarë, konsultimet publike, këshillat e lagjeve, planifikimi me pjesëmarrje” (Bherer et al. 2016: 225) dhe e-demokracia (Rodean 2011).

- **demokracia deliberative**


Demokracia deliberative paraqet një zhvendosje nga vendimmarrja e bazuar në preferenca (votim), në vendimmarrje të bazuar në diskutim nga publiku ose nga zyrtarët e zgjedhur. Mekanizmat konkretë të demokracisë deliberative përfshijnë sondazhet deliberative dhe juritë e qytetarëve (Fishkin dhe Luskin 2005; Kim et al. 2018).

- **alter-demokracia**

Alter - demokracia përfshin të gjitha format e aktivizmit dhe pjesëmarrjes popullore që ekzistojnë si kundëreagime ndaj proceseve të vendosura demokratike (Rosanvallon 2008; krh. Gajdziński 2016).

Pierre Rosanvallon, i cili përdori për herë të parë termin alter-demokracia shpjegon se demokracia nuk është vetëm e përcaktuar nga institucionet e saj, ajo nuk përcaktohet vetëm

nga vota, por përcaktohet edhe nga roli i qytetarit³. Mekanizmat konkretë (Dean, 2018) të alter - demokracisë janë grevat industriale dhe civile, protestat shoqërore, thirrjet dhe petitionet, mbulimi mediatik, lëvizjet sociale dhe angazhimi i OJF-ve, forma të ndryshme të denoncimit të qytetarëve ose ekspertëve, juritë e qytetarëve apo asamblетë qytetare etj.




3 <https://www.graduateinstitute.ch/communications/news/counter-democracy-and-democratic-oversight>

	Demokracia e drejtpërdrejtë	Demokracia Përfaqësuese	Demokracia Pjesëmarrëse	Demokracia Deliberative	Alter- demokracia
JUSTIFIKIMI	Të drejtat	Votimi në referendum, dhe mekanizma të tjerë të demokracisë së drejtpërdrejtë	Votimi në zgjedhje	Organe zyrtare/ shtetërore që përfshijnë rininë	Struktura zyrtare/ shtetërore për dialog ndërmjet përfaqësuesve të lëvizjeve shoqërore dhe institucioneve
	Fuqizimi	Nisja e referendumeve, peticioneve dhe mekanizmave të tjerë të demokracisë së drejtpërdrejtë	Kandidim për poste zyrtare	Organet vendimmarrëse që përfshijnë drejtpërdrejtë të rinjtë në hartimin e politikave.	Strukturat e drejtuara nga të rinjtë për dialog ndërmjet përfaqësuesve të lëvizjeve shoqërore dhe institucioneve
	Efikasiteti	Organe këshilluese rinore që mbështetin referendumat, peticionet dhe mekanizmat e tjerë të demokracisë së drejtpërdrejtë	Organe këshilluese rinore që sugjerojnë dhe monitorojnë politikat rinore	Organe këshilluese rinore që mbështetin diskutimet publike mbi politikat rinore	Organe e pavarura këshilluese të drejtuara nga të rinjtë që sugjerojnë dhe monitorojnë politikat rinore
	Zhvillimi	Strukturat që mundësojnë referendume për të rinjtë, peticione dhe mekanizma të tjerë të demokracisë së drejtpërdrejtë për qëllime të caktuara.	Organe që mundësojnë strukturat përfaqësuese të të rinjve për qëllime të caktuara.	Organe që mundësojnë procese konsultimi me të rinjtë për qëllime të caktuara.	OJF dhe Projekte të drejtuara nga nga të rinjtë.

Tabela: Pjesëmarrja politike e të rinjve sipas tipologjive të demokracisë

Tabela më sipër tregon në mënyrë të përmbledhur se pjesëmarrja politike e të rinjve kërkon gjithashtu një vështrim të detajuar, ndër të tjera, të arsyeve të angazhimit të të rinjve në vendimmarrje dhe synimeve të tyre. Janë paraqitur katër justifikime kryesore të pjesëmarrjes politike të të rinjve (Farthing 2012: 77; Kiilakoski 2020, UNICEF 2019) bazuar në: të drejtat; fuqizim; efikasitet dhe zhvillim. Në përgjithësi, synimet bazohen në justifikime që e bëjnë të vlefshme pjesëmarrjen e të rinjve në politikë.



2.

KUADRI LIGJOR DHE PJESËMARRJA POLITIKE E TË RINJVE

2.1 E drejta e votës dhe kuadri ligjor

Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndër të tjera garanton: “Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet”.

Pjesëmarrja qytetare dhe politike e të rinjve është perceptuar gjerësisht si një nga treguesit më të rëndësishëm për një qeverisje demokratike efektive. Argumentet, të cilat nënvizojnë rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në proceset e qeverisjes lokale janë:

Së pari, të rinjtë mund të përfitojnë nga pjesëmarrja në procesin e qeverisjes. Nëpërmjet përfshirjes në procese të vendimmarrjes dhe qeverisjes të rinjtë kanë mundësi të zhvillojnë ndjenjat e fuqizimit, kompetencës dhe lidhjes me komunitetin. Kështu, pjesëmarrja mund të përmirësojë interesat e të rinjve për t'u angazhuar në shërbimin në komunitet, veprimin politik ose në forma të tjera të angazhimit publik.

Së dyti, komuniteti mund të përfitojë nga pjesëmarrja e të rinjve.

Të rinjtë mund të ofrojnë informacione që çojnë në vendimmarrje të mira, veçanërisht në lidhje me politikat që prekin të rinjtë.

Së treti, si çështje e drejtësisë sociale, të rinjtë kanë të drejtë të angazhohen në vendime që ndikojnë në jetën e tyre. Procesi i përfshirjes së të rinjve është thelbësor në një shtet demokratik.

- **Ligji 75/2019 “Për Rininë”**

Në kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë në Ligjin për Rininë, i miratuar në vitin 2019, përcaktohet se “Të rinj” janë personat, i ri ose e re, që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç.⁴ Rezoluta 2250 e Kombeve të Bashkuara gjithashtu i përcakton “të rinjtë” si grup mosha 18 -29 vjeç, duke vënë në dukje se ka ndryshime dhe shumëllojshmëri të gjerë të përkufizimeve mbi rininë në shtetet anëtare.⁵

Në vitin 2019, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë ndërmori nismën ligjore për të hartuar një ligj të dedikuar për rininë në mënyrë që t'i jepet vëmendja e duhur kësaj kategorie të shoqërisë. Ky ligj bazohet në parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizimit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritetit dhe mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të

4 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ligji 75/2019, neni 3, pika f, https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Ligj_75_2019_04.11.2019.pdf , aksesuar 17.02.2023

5 Smith T. (2021) “Youth, Peace and Security a Programming Handbook”, UNFPA, UNDP, DPPA/PBSO, FBA

rinjve: parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe vetëqeverisjes së organizatave dhe parimin e subsidiaritetit⁶.

Ligji 75/2019, ka parashikuar ndërtimin e një sistemi funksional rinor, si dhe struktura rinore të posaçme me detyrime ligjore veçanërisht në nivel vendor. Ky ligj detyron çdo bashki që të parashikojë në strukturat e saj ngritjen e drejtorisë së rinisë. Ky detyrim ligjor e bën pushtetin vendor të ketë vëmendje të shtuar tek rinia dhe të realizojë veprime konkrete duke mandatuar stafin që do të ketë në detyrë hartimin e strategjisë lokale për të rinjtë.

- **Këshilli Vendor Rinor në Ligjin Nr. 75/2019**

Ligji i Rinisë solli risi nga pikëpamja e detyrimeve ligjore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të ngritur Këshillat Rinorë Vendorë. Nenet kryesore të ligjit që parcaktojnë bazën ligjore për rolin e Këshillit Vendor Rinor janë: Neni 5, Neni 7 dhe 10.

Neni 7 përcakton në mënyrë më të detajuar kompetencat dhe detyrimet specifike të njësive të vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë. Në nenin 10, përcaktohet se Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë.

6 vendimet të merren sa më afër të jetë e mundur me qytetarët (Fjalorth për Integrimin European, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit European, Ministria e Integritimit, 2010, fq. 142, <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/2-Fjalorth-p%C3%ABr-Integrimin-European.pdf>

Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- këshillon njësitet e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.
- Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë.
- anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.
- kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Nga pikëpamja legislative, përveç Ligjit Nr.75/2019 ku përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e vetëqeverisjes vendore, janë minimalisht edhe dy ligje që prioritojnë çështjet rinore. Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë Njësitet e Qeverisjes Vendore, ku rinia bëhet pjesë e përgjegjësisë

dhe prioritet për NJQV për funksione që i kanë kaluar pushtetit vendor. Neni 23 i këtij ligji përcakton funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike ku bëjnë pjesë mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe Neni 25 përcakton funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese. Neni 16 i këtij ligji garanton pjesëmarrjen publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes dhe Këshilli Vendor Rinor do t'i jepte një zë në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesëmarrjes së të rinjve.

Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 38, pika 2, fq. 16 përcakton iniciativat planifikuese buxhetore për të rejat dhe të rinjtë në linjë me nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjikë të hartuar për këtë qëllim.

2.2 Pjesëmarrja politike e të rinjve

Të dhënat globale tregojnë se vetëm 1.65% e parlamentarëve të të gjitha vendeve janë rreth moshës 20 vjeç dhe vetëm 11.87% e tyre janë deri në moshën 30 vjeç. Ndërkohë, mosha mesatare e deputetëve që janë pjesë e parlamenteve në të gjithë botën është rreth 53 vjeç për burrat dhe 50 vjeç për gratë.

Humbja e besimit në institucionet publike është në qendër të debatit të politikave që nga kriza financiare 2007-2008 dhe recesioni që pasoi. Pabarazitë në të ardhura dhe mundësi, papunësia dhe pasiguria në punë, mungesa e rritjes ekonomike, korrupsioni i perceptuar dhe sfidat globale kanë minuar besimin e qytetarëve në institucione (OECD, 2017[5]).

Shpesh gjeneratat e reja përdorin forma dhe kanale të reja për t'u angazhuar politikisht. Përderisa ka shumë praktika pozitive, hulumtimet e fokusuara në pjesëmarrjen e të rinjve evidentojnë se të rinjtë ende përballen me një sërë barrierash që i pengojnë ata të përfshihen në procesin demokratik. Këto barriera shpesh lidhen me motivet dhe qendrimet; njohuritë dhe informacionin; ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe çështje të lidhura me kulturën dhe gjuhën.

Të rinjtë kanë humbur besimin në institucionet publike, gjë që ngre shqetësime për legjitimitetin e institucioneve themelore demokratike. Për shembull, në 16 vende të OECD, më pak se gjysma e popullsisë totale (44%) shprehu besim në parlamentin e vendit të tyre në 2018.

Sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, neni 3, pika 3: "Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet"⁷

Në Republikën e Shqipërisë aktualisht të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç zënë 21.28% të popullatës totale (tabela II).

7 Ligji Nr.10 019/2008

	Femra	Meshkuj	Total
Numri total i popullsisë	1.394.864	1.366.921	2.761.785
Popullata e të rinjve 15-29 vjeç	293.069	294. 819	587.888
Pesha specifike e të rinjve në popullatën totale	21.01%	21.56%	21.28%

Tabela II. Raporti i popullatës së të rinjve në raport me popullatën e përgjithshme në Republikën e Shqipërisë⁸

Të rinjtë janë segmenti më i rëndësishëm i shoqërisë e si të tillë mund dhe duhet të luajnë një rol jetik në zhvillimin e vendit. Për të faktorizuar sa më shumë të rinjtë, duhen krijuar kushtet dhe mundësitë që të kontribuojnë dhe të përfshihen në shoqëri. Në një panoramë të përgjithshme klima e angazhimit dhe përfaqësimit të të rinjve në Republikën e Shqipërisë është përmirësuar, por rrugëtimi ka ende shumë sfida.

Në dekadën e fundit politikëbërësit po shqetësohen më tepër rreth rënies së pjesëmarrjes të të rinjve në proceset formale politike. Një sërë studimesh të fundit kanë nxjerrë në pah rënien e pjesëmarrjes në votime, anëtarësimin në parti politike, interesin për politikën dhe besimin në institucionet politike tek të rinjtë.

Mosbesimi i të rinjve ndaj institucioneve politike është parë si një problem i përhapur në Shqipëri dhe më gjerë në Europë. Sipas Sondazhit mbi Besimin në Qeverisje të vitit 2017, institucionet vendase kanë marrë vlerësime më të ulëta të besimit nga më shumë se gjysma e të anketuarve duke përfshirë: Pushtetin Lokal (49%), Qeverinë Qendrore (47%), Parlamentin (34%), Presidentin

⁸ Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2023: <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografikw%C3%AB-dhe-socialw%C3%AB/popullsia/publikimet/2023/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2023/> , INSTAT, aksesuar 13.09.2023

(33%), Prokurorinë (22%), Gjykatën (21%) dhe Partitë Politike (21 %)

Po sipas këtij sondazhi rezulton se në vitin 2020 kemi: ministra të rinj në qeveri në masën 0%; zëvendësministra të rinj në masën 3% ndërsa deputetët e rinj përbëjnë vetëm 4% të totalit. Përsa u takon të dhënave po për 2020, nuk kemi kryebashkiakë të rinj ndërsa evidentohen ekzistenca e strukturave rinore (këshillat/parlamentet/bordet) në nivel lokal në masën 46%⁹.

⁹ <https://www.partnersalbania.org/publication/monitorimi-i-pjesemarrjes-politike-sociale-dhe-ekonomike-te-te-rinjve-2020-raporti-per-shqipërinë/>

3.

KËSHILLI VENDOR RINOR SHIJAK

Bashkia Shijak ka një sipërfaqe prej 92.19 km², dhe densitet prej 302 banorë/km². Kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga bashkia Durrës dhe në lindje nga bashkitë Vorë dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut. Nga një popullsi prej rreth 12 mijë banorësh në fund të viteve 90, Bashkia Shijak numëron sot rreth rreth 45 mijë banorë. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 27,861 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrisë Civile numri i banorëve është 44,103. Bashkia përbëhet nga katër njësi administrative të cilat janë Shijak, Maminas, Xhafzotaj dhe Gjepalaj¹⁰.

Në bazë të të dhënave të Bashkisë Shijak, tabela III paraqet shpërndarjen e popullsisë dhe numrin e familjeve sipas 4 njësive administrative.

¹⁰ <https://aam.org.al/bashkia-shijak/>

Njësia Administrative	Popullsi	Familje
Njësia Administrative Shijak	13.497	4035
Njësia Administrative Gjepalaj	6.239	1721
Njësia Administrative Maminas	8.044	2184
Njësia Administrative Xhafzotaj	19.722	5444
TOTALI	47.502	13384

Tabela III: Numri i popullsisë në Bashkinë Shijak, 2022.

Burimi: Bashkia Shijak, 2022

Bashkia Shijak nuk zotëron një bazë të saktë të dhënash në lidhje me numrin e të rinjve në qytet dhe në njësitë administrative pjesë e territorit të bashkisë. Në Shijak ka gjithsej dy shkolla të mesme dhe 13 shkolla të ciklit 9-vjeçar. Sipas të dhënave të bashkisë, buxheti për programin e arsimit dhe për programin e argëtimit, kulturës dhe çështjeve fetare ka shënuar rritje nga viti 2018 në vitin 2022.

Këshilli Vendor Rinor Shijak është ngritur me datë 09/09/2022 me vendim 341, datë 06/09/2022 të kryetarit të Bashkisë Shijak. Ky këshill përbëhet nga 7 anëtarë dhe 5 prej tyre përfaqësojnë të rinjtë e çdo njësie administrative të Bashkisë Shijak. Veprimtaria e KVR Shijak mbështetet në tre shtylla kryesore:

- ✓ Adresimi i problemeve dhe propozimeve që të rinjtë kanë pranë pushtetit vendor
- ✓ Nxjitja e vullnetarizmit dhe aktivizmit tek të rinjtë
- ✓ Promovimi i vlerave të të rinjve

Në bazë të informacionit të dhënë nga Këshilli Vendor Rinor dhe Bashkia Shijak, rezulton se:

- Në Planin Social Vendor Shijak, të rinjtë nuk përbëjnë një kategori me një vëmendje sociale nga ana e bashkisë siç janë, personat me aftësi të kufizuara, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, punëkërkuesit e papunë, fëmijët, viktimat e dhunës në familje etj. Që në formimin e tij KVR si strukturë këshilluese pranë kryetarit të bashkisë ka kërkuar të ketë një buxhet të posaçëm për të rinjtë.
- Në mbështetje të funksionimit të KVR, është formuar Njësia Vullnetare Rinore që ka në përbërje 100 të rinj nga i gjithë territori i kësaj bashkie. Përgjatë vitit 2023 janë realizuar 21 aktivitete dhe planifikohen rreth 30 të tjera për vitin 2024 që kanë në fokus nxitjen e aktivizmit, vullnetarizmit dhe pjesëmarrjen në procese vendimarrëse.
- KVR-ja shkëmben në mënyrë periodike eksperiencat e punës me organizatat rinore dhe Këshillat Vendorë Rinorë të bashkive të tjera me qëllim rritjen e efikasitetit dhe performancës.

Puna e KVR-së duhet të jetë e dukshme për publikun dhe për çdo të ri të interesuar, si një organ publik që prezanton dhe përfaqëson interesat e të rinjve, por jo vetëm.

Disa nga informacionet më të rëndësishme për publikun në lidhje me Këshillin Vendor Rinor janë:


- Cila janë funksionet e KVR-së?
- Cili është fokusi i punës së KVR-së për të rinjtë dhe cilat janë arritjet kryesore?
- Kush e përbën atë, cilët janë anëtarët e tij dhe cilat janë rolet e tyre?

- Sa është kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Vendor Rinor?
- A ka KVR-ja programin, buxhetin dhe raportet e veta dhe si mund të gjenden ato?
- Si dhe përmes cilave kanale mund të kontaktohet KVR?

Transparenca mbi veprimtarinë e KVR-së do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të sigurt që është parakusht për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të të rinjve. Në një mjedis të sigurt çdo i ri do të ndjehet i lirë të shprehë pikëpamjet dhe të realizojë potencialin e tij të plotë.

3.1 Problematikat komunitare dhe pjesëmarrja e të rinjve në Bashkinë Shijak

Problematikat më të shpeshta komunitare të identifikuara nga të rinjtë dhe që u adresuan në Bashkinë e Shijakut rezultuan të jenë: transporti, infrastruktura rrugore, ndotja e ajrit, tokës dhe ujit, shërbimi shëndetësor, punësimi, emigrimi, siguria etj. paraqitur në mënyrë të detajuar në Grafikun I.




Grafiku I: Problematikat të konsideruara në nivel komuniteti, në përqindje¹¹
Burimi: CBC, 2023

Të dhënat e pyetësorëve me anëtarë të KVR-se dhe të rinj nga 4 njësitë administrative të Bashkisë Shijak dëshmuar vakumin e angazhimit të përgjegjedhënësve në format e angazhimit politik, qoftë ai konvencional apo jokonvencional. Të rinjtë shpesh zgjedhin të pozicionohen si qytetarë pasivë në jetën në komunitet dhe proceset e vendimmarrjes. Format kryesore të angazhimit të tyre janë jokonvencionale si: nënshkrimi i peticioneve (10%), shkrimi i letrave/email-eve për politikanë apo zyrtarë publikë (20%), shfaqja e një simboli që përfaqëson mbështetje për një kauzë politike (10%) etj. Pesha specifike e të anketuarve të cilët raportojnë se nuk janë angazhuar në asnjë formë të angazhimit politik jokonvencional është rreth 50%.

¹¹ Rezultatet e përpunuara nga të dhënat e pyetësorit me të rinj në Bashkinë Shijak

Nga ana tjetër, 80% e përgjigjedhënësve raportojnë se nuk janë angazhuar në asnjë formë të angazhimit politik konvencional si: votimi, anëtarësimi në një parti politike, kandidimi për zgjedhje politike, puna në fushata zgjedhore politike për kandidatët apo partitë, përpjekja për të bindur të tjerët të votojnë etj. Pesha specifike e të rinjve të angazhuar politikisht në mënyrë konvencionale rezultoi të jetë 20% dhe forma e angazhimit ishte votimi. Pavarësisht kornizës ligjore mbështetëse, u evidentua se të rinjtë dhe të rejtat kryesisht vendoseshin në rendin e listës “jo të sigurt” për këshillat bashkiakë.

Grafiku më poshtë shfaq përgjigjet mbi format më të shpeshta të angazhimit qytetar të të rinjve.



Grafiku II: Forma të angazhimit qytetar në përqindje.

Burimi: CBC, 2023

Në gjetjet e pyetësorit evidentohet se angazhimi qytetar i të rinjve është më i lartë sesa ai politik. Afërsisht 20% e të rinjve referojnë se nuk janë angazhuar në asnjë formë të angazhimit qytetar. Nga interpretimi i të dhënave del se shkolla si qendër komunitare është një nga format kryesore të angazhimit qytetar të të rinjve, e ndjekur nga iniciativa për ngritjen e fondeve për kauza të ndryshme, ndërmarrja e iniciativave vullnetare dhe ndihmë për mirëqenien e të tjerëve në komunitet.

3.2 Të rinjtë në proceset formale politike dhe angazhimi qytetar

Në bazë të të dhënave të pyetësorëve dhe fokus grupeve të zhvilluara me anëtarë të KRV-së dhe të rinj në këtë bashki vihet re se të rinjtë janë të distancuar nga sfidat dhe problematikat e komunitetit. Tabela e mëposhtme pasqyron një sintezë të mundësive, sfidave dhe sugjerimeve për të nxitur angazhimin politik dhe qytetar të të rinjve në Bashkinë Shijak.

Tabela III: Mundësitë dhe sfidat e angazhimit politik dhe qytetar të të rinjve

Mundësitë	Sfidat	Sugjerimet
Kornizë legjislative mbështetëse: <i>Ligji 2019/75 "Për Rininë";</i>	Përfaqësimi i pamjaftueshëm në nivelet e qeverisjes vendore	Informimi, njohja e ligjit nga të rinjtë
Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)	Mobilizimi i të rinjve në arritjen e SDG-ve	Të rinjtë si partnerë në arritjen e SDG-ve
Kornizë legjislative mbështetëse: <i>Ligji 2019/75 "Për Rininë";</i>	Besimi i vendimmarrësve në potencialin dhe në iniciativat e të rinjve. Subjektet politike i vënë të rinjtë në pozicionet e "riskut" të listës së këshillit bashkiak	Rritja e ndërgjegjësimit të vendimmarrësve, publikut, të rinjve mbi rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në qeverisje dhe politikëbërje
Kornizë legjislative mbështetëse: <i>Ligji 2019/75 "Për Rininë";</i> <i>Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"</i>	Numri i ulët i të rinjve që kandidojnë për poste të rëndësishme në nivel vendor	Ndërmarrja e hapave konkrete për zbatimin e politikave dhe strategjisë kombëtare që rritin rolin e të rinjve në komunitetet e tyre
Kornizë legjislative mbështetëse: <i>Ligji 2019/75 "Për Rininë";</i> <i>Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";</i>	Plani lokal i veprimit dhe buxhetimi për të rinjtë	Vlerësim në nivel bashkie për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e të rinjve në Shijak Hartimi i planit të veprimit vendor për rininë në Bashkinë Shijak Buxhetimi në mënyrë direkte i aktiviteteve dhe programeve për të rinjtë

Kornizë legjislativë mbështetëse: <i>Ligji Nr. 45/2016 Për vullnetarizmin; Energjia e të rinjve dhe kreativiteti;</i>	Fryma e vullnetarizmit tek të rinjtë dhe ndjenja e përkatësisë ndaj komunitetit	Aktivitete peer-learning në nivel kombëtar dhe lokal mbi vullnetarizmin
Demokratizimi i shoqërisë dhe institucione të pavarura	Mjedis i pafavorshëm social-kulturor dhe ndasi politike që kufizojnë përfaqësimin e të rinjve në nivel lokal	Rrjetëzim dhe shkëmbime të praktikave të mira të angazhimit rinor.
Programe të BE-së për bashkitë me fokus të rinjtë	Mungesë e informacionit mbi këto programe, aplikimit, zbatimit dhe vlerësimin të projekteve.	Ngritje të kapacitetve të stafit dhe zyrës së projekteve të Bashkisë Shijak Rritja e përfshirjes së të rinjve në hartimin dhe zbatimin e projekteve me fokus të rinjtë
Mbështetje e organizatave rinore dhe iniciativave të udhëhequra nga të rinjtë që kërkojnë mundësi financimi	Iniciativa dhe projekte të drejtuara nga të rinjtë	Krijimi i grupeve rinore joformale dhe organizatave rinore në Bashkinë Shijak
Platforma në mediat sociale, ku të rinjtë mund të shprehin pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre	Përfshirje e ulët e të rinjve në çështje të lidhura me komunitetin dhe rininë.	Përdorimi i mjeteve dhe formave inovative të pjesëmarrjes demokratike si psh. mjetet e demokracisë dixhitale Intensifikimi i fushatave ndërgjegjëse që promovojnë rëndësinë sociale të angazhimit të të rinjve në qeverinë lokale dhe zhvillimin e komunitetit Programe sensibilizuese në media mbi pjesëmarrjen e barabartë politike dhe qytetare të të rejave dhe të rinjve

Si përfundim mund të veçojmë se, politikanët dhe institucionet politike shpesh perceptohen nga të rinjtë se kanë pak interes për pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre dhe si rrjedhojë shumë të rinj ndihen të përjashtuar nga arena politike. Për këtë arsye, ata kërkojnë dhe përdorin forma alternative të angazhimit qytetar dhe politik¹². Është e nevojshme të kryhen raporte vlerësuese monitorimi nga bashkia për të vlerësuar pjesëmarrjen reale qytetare dhe politike të të rinjve. Kjo do të ndihmojë në hartimin e rekomandimeve të duhura në funksion të nxitjes dhe fuqizimit të pjesëmarrjes politike, adresimin e çështjeve rinore dhe në angazhimin e të rinjve në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjithashtu angazhimi efektiv i të rinjve çon në rezultate pozitive për të rinjtë në tre nivele si:

- Nivel individual: p.sh. rritja e aftësive personale, ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë;
- Nivel social: p.sh. lidhje më të forta pozitive në komunitet dhe një rrjet më i madh mbështetës;
- Nivel sistemi: angazhim më i madh qytetar, politika dhe programe që u përgjigjen nevojave të të rinjve, etj¹³.

Mbështetur në Ligjin 75/2019, Bashkia Shijak në bashkëpunim me KVR-në dhe aktorë të tjerë lokalë duhet të hartojë një plan lokal veprimi për rininë. Në bashki nuk ka një plan sektorial për rininë që të bazohet dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për

Martyn Barrett and Dimitra Pachi (2019). Youth civic and political engagement. 9781848721616_oachapter3.pdf (oopen.org) aksesuar (10.09.2023)

13 Pan-Canadian Joint Consortium for School Health Youth Engagement Toolkit


Rininë. Në këtë kuadër, mbetet prioritar organizimi i sesioneve të hapura dhe dëgjesave publike me fokus të veçantë të rinjtë dhe hartëzimin e nevojave të tyre. Për të siguruar pjesëmarrjen në këto sesione të dëgjesa, duhet të organizohen takime të shkurtra informuese në shkollat e qytetit dhe të zonave rurale, ku të ftohen të rinjtë të bëhen pjesë e dëgjesave që do të organizojë bashkia. Në këto takime duhet të paraqitet dhe kalendari i dëgjesave që mendohet të organizohen. Në kuadër të programit të transparencës, një kopje e këtij kalendari me datat, oraret dhe vendin e organizimit të këtyre dëgjesave, duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë¹⁴. I gjithë ky proces do të ndihmojë në rritjen e niveleve të angazhimit në forma qytetare vullnetare dhe të tjera forma joformale për të sjellë ndryshim në komunitet.

Në një plan makro aktorët politikë kanë marrë përgjegjësinë dhe iniciativën e të konsideruarit të rinisë partner në bashkëqeverisje. Kjo shprehet qartë dhe në frymën e Ligjit për Rininë si shtylla bazë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Iniciativa të tilla makro-politike duhet të gjejnë terren implementimi në njësitë vendore si dhe gatishmërinë e të rinjve për të reflektuar mbi oportunitetet dhe përgjegjësitë e sipërmarrjeve të tilla. Në këtë këndvështrim të rinjtë dhe të rejat lipset të kenë potencial ndërgjegjësimi për rolin e tyre të rëndësishëm, sepse ndër të tjera ata sigurojnë: vazhdimësinë, mbrojtjen dhe rritjen e shoqërisë¹⁵.

14 Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, “Të Buxhetojme për Rininë me Rininë”, Bashkia Shijak

15 Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 RENJK_500_I. Strategjia Kombetare e Rinisë 2022.pdf, 17.02.2023

Me synim promovimin dhe mbrojtjen e demokracisë dhe shtetit të së drejtës pjesëmarrja politike gjithëpërfshirëse është një e drejtë themelore politike. Mirëqeverisja në shtetet demokratike lidhet drejtpërdrejt me pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Si rrjedhojë, në kuadër të avancimit të procesit të decentralizimit, qeveritë lokale luajnë një rol kyç në mbështetjen e të rinjve si katalizatorë të ndryshimeve pozitive, përmes përfshirjes së tyre në vendimmarrjen lokale.



4.

SKEDA PUNE PËR KËSHILLIN
VENDOR RINOR

Aneksi 1. Barrierat strukturore dhe individuale në përfshirjen e të rinjve në nivel lokal

Identifikimi i barrierave kryesore personale dhe strukturore për përfshirjen lokale të të rinjve në 4 fusha: Edukimi, Punësimi, Shëndeti dhe Pjesëmarrja.

Faktorët e riskut dhe barrierat	Po/Jo	Komente
EDUKIMI		
Barriera strukturore		
Kompetencat dhe motivimi i mësuesit		
Mjedis i përshtatshëm për të mësuar		
Stigmatizimi dhe diskriminimi		
Tjetër		
Barriera personale		
Nevoja për të punuar dhe mbështetur familjen		
Konteksti ekonomik dhe social		

Rezultate të dobëta në mësim		
Familje që nuk i kushtojnë rëndësi edukimit		
Pabarazitë gjinore		
Tjetër		
PUNËSIMI		
Barriera strukturore		
Të qenit i ri		
Kualifikime të pakta		
Mbikualifikime		
Mospërputhje e edukimit të marrë në shkollë me nevojat e tregut të punës		
Punë të keqpaguara dhe jo në profil		
Kontrata të për-kohshme		
Diskriminim i bazuar në gjini		
Tjetër		
Barriera personale		
Prind i vetëm dhe shtatzaninë e hershme		
Probleme të shëndetit fizik dhe mendor		
Tjetër		

SHËNDETI		
Barriera strukturore		
Barrierat ekonomike		
Barriera në lidhje me statusin ligjor (emigrant, i pastrehë)		
Mbulimi dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore		
Masa dhe politika të cilat janë të keqinterpretuara dhe jo të zbatuara		
Akses i pabarabartë në institucionet shëndetësore		
Mungesa e edukimit shëndetësor dhe informacionit		
Paragjykime dhe diskriminime ndaj grupeve të veçanta		
Tjetër		
Barriera individuale		
Mungesa e njohurive		
Mungesa e informimit dhe ndërgjegjësimit		
Stili i jetesës		
Besimi i ulët i të rinjve në institucionet shëndetësore		
Tjetër		

PJESEMARRJA		
Barriera strukturore		
Perceptimi i të rinjve se institucionet dhe organizatat janë njohës jo të mirë të problematikave të tyre		
Akses i kufizuar në strukturat vendimmarrëse për të rinjtë		
Mungesa e të dhënave sasiore dhe treguesve për të matur impaktin e angazhimit dhe përjashtimit social të të rinjve		
Mekanizma jo të përshtatshëm për të mundësuar përfshirjen e të rinjve		
Problemet ekonomike, vendodhja gjeografike dhe mungesa e kohës janë pengesat kryesore për angazhimin afatgjatë të të rinjve		
Politika formale dhe struktura angazhimi që janë të paaksesueshme për grupe të veçanta		
Tjetër		

Barriera individuale		
Mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimit mbi të drejtat		
Mungesa e përkatësisë komunitare		
Mungesa e kompetencave për jetën		

Angazhimi i përditshëm për të përmbushur nevojat ekonomike		
Të rinj të cilët nuk e shohin veten e tyre si të pavarur		
Mungesa e besimit tek institucionet dhe organizatat		
Tjetër		



Aneksi 2. Vlerësimi i nivelit të përfshirjes, angazhimit komunitar dhe fuqizimit të të rinjve në programet për të rinjtë


Një komponent kyç për vlerësim nga KVR-ja është dhe vlerësimi i angazhimit të të rinjve si pjesëmarrës aktivë në programet për të rinjtë. Ky vlerësim mund të zhvillohet çdo gjashtë muaj duke përdorur pyetësin e vlerësimit të pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve¹⁶. Shkalla e vlerësimit të pyetësit varion nga 1 (nuk pajtohem plotësisht) në 5 (plotësisht dakord), duke treguar nëse programi ofron përvoja pozitive ose negative në secilën nga tre fushat, përfshirja, angazhimi komunitar dhe fuqizimi i të rinjve. Pikët si mesatare për secilën kategori midis 1 dhe 2.4 klasifikohen si “e ulët”, pikët midis 2.5 dhe 3.4 konsiderohen “mesatare” dhe 3.5 ose më lart klasifikohen si “të larta”. Krahasoni këto rezultate të pyetësit me tabelën e mëposhtme për të përcaktuar se cilat fusha mund të kenë nevojë për përmirësim. Shigjetat në tabelë tregojnë nëse nivelet janë “të ulëta” (↓) ose “të larta” (↑). Këto përshkrime janë paraqitur në tabelë, se bashku me shpjegimet mbi shkaqet e mundshme të niveleve të ulëta ose mesatare në çdo kategori.


¹⁶ Linku i pyetësit: <https://youthrex.com/wp-content/uploads/2019/10/Youth-Involvement-and-Engagement-Assessment-Tool.pdf>

Përfshirja e të rinjve	Angazhimi komunitar	Fuqizimi i të rinjve	Përshkrimi
↑	↑	↑	Përfshirje, angazhim dhe fuqizim i lartë Ky është rezultati optimal për zhvillimin pozitiv të të rinjve dhe tregon që të rinjtë janë të fuqizuar për të promovuar ndryshimin. Ata janë përtej përfshirjes së thjeshtë dhe po vënë në praktikë ato aftësi drejtuese që janë zhvilluar me kalimin e kohës. Programet që arrijnë pjesëmarrjen e të rinjve në këtë nivel optimal ka të ngjarë të zbatojnë praktika që nuk janë episodike, por përkundrazi janë të qëndrueshme. Kjo është e dukshme për shkak të numrit të lartë të të rinjve të gatshëm për të qëndruar aktivë në një program. Të rinjtë janë në gjendje të marrin role vendimmarrëse dhe kanë mundësi për të zhvilluar aftësitë e tyre.




			Angazhim i ulët Programet e zhvillimit të të rinjve mund të hartohen me qëllime objektive, por të rinjtë luajnë një rol kritik në përcaktimin e suksesit në nivelin e përfshirjes së tyre. Të rinjtë mund të jenë forcë shtytëse pas një nisme të re që mund të përfitojë komuniteti dhe të shërbejnë si drejtues të komunitetit, por shpesh ndodh që nuk janë aktivë në realizimin e iniciativës. Rezultatet e ulëta ose mesatare të angazhimit të të rinjve (1 deri në 3.4) tregojnë se të rinjtë pjesëmarrës kanë nevojë për më shumë trajnime në këtë fushë. Duhet kohë që të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e veçanta dhe të transferueshme që kërkohen për të funksionuar në mënyrë efektive si udhëheqës të sigurtë dhe kompetentë. Këto trajnime duhet të drejtohen nga parimet bazë të vlerësimit të nevojave (çfarë i nevojitet komunitetit tonë?) hartës së burimeve (çfarë burimesh zotërojnë?) etj. Të rinjtë, si dhe të rriturit, duhet të kenë njohuri mbi këto tema nëse duan të zhvillojnë një ndjenjë më të fortë komunitare. Është gjithashtu e rëndësishme që të rinjtë të edukohen mbi aftësitë që nxitin vendosjen e qëllimeve, komunikimin, të menduarit kritik dhe aftësinë për të menaxhuar konfliktin.
---	---	---	---

			Përfshirje e ulët Kjo është e zakonshme kur programet janë të reja ose nëse të rinjtë sapo kanë filluar të fitojnë përvoja si qytetarë të angazhuar. Ata mund të mos ndihen të përgatitur të marrin iniciativën për të udhëhequr projekte ose të mbështeten në aftësitë e tyre për të marrë vendime kyçe. Disa teknika që mund të ndihmojnë në rritjen e përfshirjes së të rinjve janë renditur më poshtë: • Rekrutoni të rinj që janë drejtues me përvojë në projekte ose iniciativa komunitare duke i bashkuar me ata që janë më të rinj dhe me më pak përvojë. • Sigurohuni që të rinjve t'u ofrohen mundësi për të punuar në mënyrë të pavarur. Ofrojuni të rinjve mundësi që të marrin vendime dhe të shprehin mendimet e tyre. • Kurdoherë që është e mundur, lejojini të rinjtë të vendosin se çfarë projekti dëshirojnë të zbatojnë. • Mbështetja e të rriturve kur të kërkohet është e rëndësishme, sepse pavarësisht punës së pavarur, të rinjve u nevojitet ndihmë.
--	--	--	---

			Angazhim dhe fuqizim i ulët Kjo mund të jetë një situatë ku shumica e pjesëmarrësve të rinj largohen për arsye të ndryshme. Merrni kohë për të përcaktuar nëse të rinjtë janë të shkëputur për shkak të përvojave jo të mira dhe në të njëjtën kohë, sigurohuni që të përqendroheni tek të rinjtë që janë të përfshirë dhe të zhvilloni aftësitë e tyre më tej. Hapat për të përmirësuar angazhimin dhe fuqizimin e të rinjve: • Merrni kohë gjatë takimeve në kuadër të projekteve ose iniciativave për të rinj për të diskutuar çështjet që prekin komunitetin. Të rinjtë dhe të rriturit duhet të sjellin çështje komunitare për t'i diskutuar në këto takime; • Krijoni mundësi për të rinjtë që të vendosin nëse duan të zhvillojnë plane veprimi për të adresuar ndonjë shqetësim specifik. Nëse nuk shfaqin interes për një çështje të caktuar, gatishmëria e tyre për t'u angazhuar do të ulet ndjeshëm; • Partneritetet me të rinjtë në nivel lokal dhe kombëtar janë rritur dhe janë shumë të dobishme në promovimin e angazhimit të tyre. Një partneritet mund t'u sigurojë të rinjve disa mentorë të rritur, dhe nga ana tjetër, të rinjtë mund të ofrojnë eksperiencën e tyre për ato çështje që janë të rëndësishme për ta dhe bashkëmoshatarët e tyre.
--	--	--	--

			Partneritetet mund të balancojnë përgjegjësitë midis të rinjve dhe të rriturve ndërsa ata përpiqen të bëjnë një ndryshim në komunitet; Në disa raste, të rinjtë mund të mos jenë të gatshëm të merren me çështje në një shkallë më të gjerë. Në këtë rast mund të jetë më e rëndësishme të shpenzoni më shumë kohë për të zhvilluar aftësitë e tyre drejtuese dhe sociale nëpërmjet përfshirjes, në mënyrë që t'i fuqizoni ata për angazhim qytetar dhe politik.
			Angazhim i lartë Angazhimi i lartë i referohet të rinjve që kontribuojnë duke përdorur aftësitë e mësuara dhe iu jepet mundësi për të vepruar si vendimmarrës efektivë. Të rinjtë kanë besim për të pranuar role drejtuese dhe kompetencë për të marrë vendime, ndaj ata kërkojnë mundësi për të qenë pjesë në programe dhe iniciativa të drejtuara nga ata. Të rinjtë gjithashtu i përdorin aftësitë e tyre duke u përfshirë në organizata, duke marrë pjesë në çështjet qytetare apo duke shërbyer në borde dhe këshilla. Një tjetër rast i lidhur me angazhimin e lartë ndodh kur të rinjtë largohen nga programi ose projekti dhe përfshihen në role më të gjera në komunitetin e tyre.

			Bashkëpunoni me ta për të përcaktuar nëse programi juaj ka patur një rol në dëshirën e tyre për të ndjekur nivele më të larta të angazhimit në komunitet. Nëse po, programi ka arritur qëllimin kryesor në zhvillimin pozitiv të të rinjve, veçanërisht nëse të rinjtë janë duke shërbyer në role udhëheqëse brenda grupeve dhe organizatave të tjera.
↑	↑	↓	Përfshirje dhe angazhim i lartë, fuqizim i ulët. Kjo mund të ndodhë kur të rinjtë detyrohen të zgjedhin mundësi të tjera (p.sh., punë, aktivitete sportive, studime), pavarësisht se kanë përvoja pozitive brenda një programi të caktuar për të rinjtë ose në nivel komunitar.
↓	↓	↑	Përfshirje dhe angazhim i ulët, fuqizim i lartë. Kjo mund të ndodhë kur të rinjtë lejohen vetëm si pjesëmarrës pasivë. Ata mund të jenë pjesë e një programi, por nuk kanë asnjë rol në vendimmarrje. Suksesi në fuqizimin e të rinjve në programe demonstron nga rikthimi i vazhdueshëm i të rinjve në program në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore. Duhet të jetë e qartë se ata po bëjnë një zgjedhje për të marrë pjesë kur kanë mundësi të tjera për të zgjedhur. Më poshtë janë renditur disa faktorë që mund të nxitin aktivizmin, por nuk kufizohen vetëm në:

			• Njohja dhe vlerësimi i të rinjve për përpjekjet e tyre; • Optimizmi i të rinjve për t'u njo- hur vendimmarrës dhe liderë në komunitet; • Interes i të rinjve për çështjet që trajtohen; • Inkurajimi i të rinjve të tjerë që t'i bashkohen ekipit për të mbështetur iniciativat e ndërmara.
			Përfshirje, angazhim dhe fuqizim i ulët Është koha për të konsideruar strategji të reja dhe më e rëndësishmja të kërkon këshilla nga të rinjtë. Lipset të krijohen bashkëpunime me komunitetin për të përcaktuar se çfarë kanë vërtet nevojë të rinjtë në zonën ku jetojnë. Rezultatet e ulëta ose mesatare të fuqizimit të të rinjve (1 deri në 3.4) pasqyrojnë marrëdhënie të dobëta ose largim të të rinjve të përfshirë. Ndonjëherë, strategjitë që të rriturit vënë në veprim për të rekrutuar të rinjtë mund të mos jenë efektive. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të kërkon këshillën e të rinjve, duke i pyetur se çfarë besojnë se janë të nevojshme për aktivizimin e të rinjve të tjerë. Puna brenda komunitetit mund të shërbejë si një mjedis për zhvillim, edhe pse të rinjtë kanë dëshirë për t'u shoqëruar me bashkëmoshatarët, ata duhet të krijojnë ura bashkëpunuese edhe me të rriturit.

		Një tjetër shkak për fuqizimin e ulët deri në mesatar të të rinjve mund të lidhet me mungesën e interesit për një program të caktuar. Kjo mund të jetë e vërtetë edhe për të rinjtë që duan të zbatojnë një ide, por që kanë pak mbështetje nga bashkëmoshatarët skeptikë ose të rriturit. Rezultati përfundimtar në të dyja rastet është se pjesëmarrësit do të braktisin programin ose projektin. Së fundmi, vendndodhja e organizimit të aktiviteteve mund të ndikojë në angazhim. Mund të jetë një sfidë për të rinjtë të marrin pjesë vazhdimisht në aktivitete nëse jetojnë në një zonë të largët rurale. Sugjerimet për të përmirësuar përfshirjen, angazhimin dhe fuqizimin e të rinjve mund të jenë: • Të rinjtë duhet të njohin programet dhe t'u tregojnë të rinjve të tjerë për mundësitë që krijojnë vetërealizim duke kaluar një kohë të vlefshme; • Pjesëmarrësit më të rinj mund të fitojnë përvoja duke u mentoruar nga bashkëmoshatarët më të mëdhenj. Ata do t'i ndihmojnë pjesëmarrësit e rinj në krijimin dhe përmirësimin e programeve që kanë në fokus të rinjtë; • Njohja e përpjekjeve të të rinjve në mënyrë periodike;
--	--	---

			• Mjedisi ku angazhohen të rinjtë të jetë i sigurt, mikpritës dhe gjithë-përfshirës. • Ndryshimi i fokusit të programit ose projektit. Nëse të rinjtë vijnë për një kohë të shkurtër dhe më pas largohen nga programi, atëherë mund të jetë koha për të ndryshuar programin ose projektin.
--	--	--	---

Aneksi 3. Intrumenti i Rrjetit të Qëllimeve

Qëllimet janë kushte që ne i përfytyrojmë si pjesë e së ardhmes sonë. Çdo kusht i imagjinueshëm mund të shqyrtohet nga dy këndvështrime: (1) nëse e duam apo jo dhe (2) nëse e kemi apo jo. Atëherë mund të bëjmë dy pyetje në lidhje me çdo kusht të mundshëm (d.m.th., “qëllimi”):

1. E duam atë?

2. A e kemi atë?

Të dyja pyetjet përgjigjen me “Po” ose “Jo” dhe ndërveprimi i këtyre përgjigjeve “Po” ose “Jo” krijon katër kategori qëllimesh paraqitur si më poshtë:

- Arritja e qëllimeve (kushtet që duam por nuk i kemi)
- Ruajtja e objektivave (kushtet që duam dhe i kemi aktualisht)
- Shmangja e qëllimeve (kushtet që nuk i duam dhe nuk i kemi)
- Eliminoni objektivat (kushtet që kemi por nuk i duam)

9

Eduam até?

PO

I Arritje ❖ Plani Lokal i Veprimit për Rininë ❖ Kalendar vjetor të aktiviteteve	III Shmangia ❖ Autoritarizmi në vendim-marrje ❖ Politika lokale rinore jo gjithëpërfishrëse
II Ruajtja ❖ Kreativiteti dhe entuziazmi i të rinjve ❖ Iniciativat rinore dhe vullnetarizmi	IV Eleminimi ❖ Barrierat për progres ❖ Subjektet politike të vënë të rinjtë në pozicionet e "riskut" të listës së këshillit bashkiak

PO

E duam atë?

JO

Aneksi 4. Raport vjetor pune i KVR

Vendi dhe data

Nr. protokolli

Raport vjetor pune i Këshillit Vendor Rinor Shijak

XX/X/ 20XX

Përgatitur nga: Këshilli Vendor Rinor Shijak

Ky dokument jep informacion mbi zbatimin e programit të Këshillit Vendor Rinor Shijak, për vitin 20XX.

Qëllimi 1: Shembull – Forcimi i pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimarrëse lokale.

Lista e aktiviteteve të kryera:

Aktiviteti 1:

Titulli i aktivitetit:

Përshkrimi i qëllimit dhe objektivave të aktiviteteve:


Rezultatet e arritura:

Informacion sasior (numri i pjesëmarrësve, numri i takimeve të kryera, profilet e palëve të interesuara dhe përfshira):

Aktiviteti 2:

Aktiviteti 3:

- Pikat e forta në arritjen e qëllimit kryesor të aktiviteteve
- Pikat e dobëta në arritjen e qëllimit kryesor të aktiviteteve
- Propozime për aktivitete follow-up



Aneksi 5. Formular vetëvlerësimi i punës së Këshillit Vendor Rinor

Ky formular është i rëndësishëm dhe mund të shërbejë si një model i vlerësimit të efektivitetit, suksesit dhe impaktit të Këshillit Vendor Rinor: Realizimi i këtij procesi mund të ndihmojë anëtarët e KVR të reflektojnë mbi punën e kryer, atë që kanë arritur përmes aktiviteteve të kryera dhe se çfarë mund të bëjnë më mirë si anëtarë të Këshillit Vendor Rinor.

Kriteret bazë për vlerësimin e aktiviteteve të Këshillit Vendor Rinor	Në varësi të përmbushjes ose jo, zgjidhni nga 1 në 5, 1 qëllimi ose aktiviteti nuk është arritur dhe 5 është që qëllimi ose aktiviteti është arritur plotësisht. <i>Shembujt duhet të jepen si provë për çdo përgjigje pohuese!</i>
KVR ka anëtarë aktivë, të cilët janë zgjedhur nga format e organizimit të rinjve	
KRV njihet nga të rinjtë në komunitet, ka identifikuar nevojat dhe sfidat me të cilat përballen.	
Anëtarët e Këshillit Rinor Vendor japin mendime, propozime ose rekomandime për punonjësit e bashkisë, këshilltarët ose kryetarin e bashkisë.	
KVR organizon mbledhje dhe seanca të rregullta për të cilat përgatiten procesverbale	
KVR ka dokumentet e veta që rregullon dhe drejton punën (për shembull, një Rregullore e Punës së KRV, një program vjetor pune, etj.)	

KVR mban komunikim me Zyrtarin e Rinisë nga Bashkia	
KVR komunikon/bashkëpunon me Këshillat e tjerë Vendorë Rinorë dhe ndan praktikat e mira	
KVR promovon pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të të rinjve, përfshirjen dhe bashkëpunimin ndërkulturor	
Ndryshime të evidentuara për të rinjtë në komunitetin lokal përmes punës së KVR	
Janë marrë në konsideratë propozimet e KVR drejtuar Bashkisë (Këshillit të Bashkisë, Kryetarit, punonjësve në Bashki, institucioneve të tjera).	
KVR ka shënuar arritje që kanë ndikuar jetën e të rinjve në komunitetin e tyre.	
KVR ka bërë që bashkia të ndryshojë qasjet ekzistuese ose të krijojë të reja për të rinjtë në Njësitë Administrative.	
KVR konsulton dhe inkurajon të rinjtë që t'i bashkohen Këshillit dhe përcjell pikëpamjet dhe nevojat e tyre në bashki.	
KVR kërkon llogaridhënie dhe vlerëson efektivitetin e drejtuesve të KVR, aktivitetin dhe angazhimin e tyre në pozicionin që mbulojnë.	
KVR i merr vendimet individualisht dhe nuk ndikohet nga Bashkia apo struktura të tjera të jashtme.	

REFERENCAT

- 1- Augsburg A.; Collins M.; Gecker. W (2017). "Best Practices for Youth Engagement in Municipal Government", w, Vol. 106 <https://www.jstor.org/stable/10.1002/naticivirevi.106.1.0009>
- 2- Albert Hirschman Centre on Democracy. (2020). "Counter-democracy" and democratic oversight". <https://www.graduateinstitute.ch/communications/news/counter-democracy-and-democratic-oversight>
- 3- Bárta O. and Lavizzari A. (2021). "INSIGHTS – MEANINGFUL YOUTH POLITICAL PARTICIPATION IN EUROPE", Council of Europe and European Commission https://pipeu.coe.int/documents/42128013/105305579/085521+Insights+into+YPP_web.pdf/2b0876d8-d0fb-158e-7a72-1f5c2430435f
- 4- Barrett M. and Pachi D. (2019). "Youth Civic and Political Engagement", Routledge, 2019, https://library.oapen.org/bitstream/handle/20.500.12657/41408/9781848721616_oa_chapter3.pdf?sequence=1&isAllowed=y
- 5- Călăfăteanu A. and Lopez M. (2017). "T-KIT 8 Social Inclusion", the training kits series, Council of Europe, <https://pip-eu.coe.int/documents/42128013/47262484/T-Kit+8+Social+inclusion+WEB.pdf/ab8390b6-2d9e-f831-bbcf-85972152e6e0>
- 6- INSTAT, Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2023 <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2023/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2023/>

- 7- Jones, K.R. (2006). Youth-adult partnerships: Are you there yet? How to evaluate your youth development program, University of Kentucky. <https://youthrex.com/wp-content/uploads/2019/10/Youth-Involvement-and-Engagement-Assessment-Tool.pdf>
- 8- Ligji Nr.10 019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, https://www.pp.gov.al/rc/doc/kodi_zgjedhor_24.pdf
- 9- Ligji Nr. 75/2019 “Për Rininë” <https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>
- 10- Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 <https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-Kombetare-e-Rinise-2022-2029-1.pdf>
- 11- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf
- 12- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr-68-date-27.4.2017.pdf>
- 13- Ligji Nr. 45/2016 Për vullnetarizmin <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2020/05/ligj-2016-04-28-45.pdf>
- 14- Ministria e Integrimit. (2010). Fjalorth për Integrimin Europian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Europian, <https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/2-Fjalorth-p%C3%ABr-Integrimin-Europian.pdf>
- 15- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve. (2020). “TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË” Bashkia Shijak, <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Buxhetimi-per-rinine-Shijak.pdf>

- 16-Pan-Canadian Joint Consortium for School Health, "Youth Engagement Toolkit" Linku: https://www.gov.pe.ca/photos/original/eecd_YETOOL_E.pdf
- 17-Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri), 2020 "MONITORIMI I PJESEMARRJES POLITIKE, SOCIALE DHE EKONOMIKE TË TË RINJVE 2020 - RAPORTI PËR SHQIPËRINË" [HTTPS://WWW.PARTNERSALBANIA.ORG/PUBLICATION/MONITORIMI-I-PJESEMARRJES-POLITIKE-SOCIALE-DHE-EKONOMIKE-TE-TE-RINJVE-2020-RAPORTI-PER-SHQIPERINE/](https://www.partnersalbania.org/publication/monitorimi-i-pjesemarrjes-politike-sociale-dhe-ekonomike-te-te-rinjve-2020-raporti-per-shqiperine/)
- 18-Smith T. (2021) "Youth, Peace and Security A Programming Handbook", UNFPA, UNDP, DPPA/PBSO, FBA https://www.un.org/peacebuilding/sites/www.un.org.peacebuilding/files/documents/yps_programming_handbook.pdf
- 19-Sherifaj E. (2021) Raporti i monitorimit të "Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve", Shqipëria 2020, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2021/12/Indeksi-pjesemarrjes-se-te-rinjve-2020-Shqiperia.pdf>
- 20-Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, 2023 <https://aam.org.al/bashkia-shijak/>
- 21-Todorovska J.(2021)"Manual for Local Youth Councils", OSCE Mission to Skopje, <https://www.osce.org/files/f/documents/3/b/491132.pdf>
- 22-UNDP, "YOUTH, POLITICAL PARTICIPATION AND DECISION-MAKING" <https://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-political-participation.pdf>
- 23-VKM Nr.969, datë 02.12.2020, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të rinisë, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij".

SHTOJCË

PYETËSOR PËR PROBLEMATIKAT E KOMUNITETIT NË BASHKINË SHIJAK

Në kuadër të implementimit të iniciativës “Pjesëmarrja politike e të rinjve në zgjedhjet lokale: “Kryetar bashkie për një ditë” në Bashkinë e Shijakut, dhe themelimit të “Bordit Rinor Lokal për Angazhim Qytetar dhe Politik” është e nevojshme të identifikohen problematikat kryesore të të rinjve dhe të komunitetit në këtë Bashki sipas perspektivës së të rinjve.

Të dhënat tuaja do të përdoren vetëm për aktivitetet e këtij projekti bazuar në standartet e anonimitit të përgjigjedhënesit.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

1. Deklaroj se pranoj të plotësoj pyetesorin në liri të plotë: *
 - 1- po
 - 2- jo

2. Gjinia*
 - 1- vajzë
 - 2- djalë
 - 3- _____

3. Vendbanimi*

- 1- qytet
- 2- fshat

4. Mosha*

5. Keni qenë më herët pjesë në projekte me fokus të rinjtë? *

- 1- po
- 2- jo

6. A keni qenë ndonjëherë të angazhuar në veprimtari në shërbim të komunitetit tuaj? *

- 1- po
- 2- jo

7. A jeni përfshirë më parë në forma të angazhimit politik konvencional? Zgjidhni format e angazhimit*

- a. Votimi
- b. Anëtarësimi në një parti politike
- c. Kandidimi për zgjedhje politike
- d. Puna në fushata zgjedhore politike për kandidatët apo partitë
- e. Nuk jam angazhuar më parë

8. A jeni angazhuar më parë në forma të angazhimit politik jokonvencional? Zgjidhni format e angazhimit*

- a. Protesta, demonstrata, marshime
- b. Nënshkrimi i peticioneve
- c. Shkrimi i letrave/email-eve për politikanë apo zyrtarë publikë
- d. Shkrimi i letrave/email-eve/telefonatave me përmbajtje politike për mediat
- e. Shkrimi i artikujve/blogeve me përmbajtje politike për mediat

- f. Përdorimi i faqeve të rrjeteve sociale në internet për t'iu bashkuar grupeve që kanë fokus politik
 - g. Përdorimi i faqeve të rrjeteve sociale në internet për të shpërndarë ose ndarë lidhjet që kanë një përmbajtje politike për miqtë dhe kontaktet
 - h. Veshja ose shfaqja e një simboli ose shenje që përfaqëson mbështetje për një kauzë politike
 - i. Shpërndarja e fletëpalosjeve që shprehin mbështetje për një kauzë politike
 - j. Pjesëmarrja në ngjarje për mbledhjen e fondeve për një kauzë politike
 - k. Shkrimi ose spërkatja e grafitëve në mure që shprehin mbështetje për një kauzë politike
 - l. Pjesëmarrja në veprime të tjera të paligjshme (p.sh. djegia e flamurit kombëtar, gjuajtja e gurëve, trazira) në mbështetje të një kauze politike
 - m. Nuk jam angazhuar më parë
9. A jeni angazhuar më parë në forma të angazhimit qytetar? Zgjidhni format e angazhimit*
- a) Ndihmë për mirëqenien e të tjerëve në komunitet
 - b) Zgjidhja e problemeve të komunitetit nëpërmjet anëtarësimit në organizatat me bazë komuniare.
 - c) Anëtarësimi në organizata të tjera jopolitike (p.sh., institucione fetare, sporte, klubet)
 - d) Shërbimi komunitar i bazuar në shkollë
 - e) Ndërmarrja e punës së organizuar vullnetare
 - f) Ndihmë për përkthimin dhe plotësimin e formularëve për folësit joamtarë
 - g) Donacione për bamirësi
 - h) Nisma për ngritjen e fondeve për kauza të ndryshme
 - i) Aktivizmi konsumator: bojkotimi dhe blerja (blerja preferenciale)
 - j) Nuk jam angazhuar ndonjëherë

10. Cilat konsideroni si problematika emergjente të komunitetit tuaj? *

- a. Akses në edukim
- b. Strehim i përballueshëm
- c. Cilësia e ajrit
- d. Infrastruktura dhe urbanistika e qytetit
- e. Standartet e ndërtesave
- f. Shërbimi shëndetësor
- g. Siguria ushqimore
- h. Mbrojtja e konsumatorit
- i. Jeta në komunitet
- j. Krimi
- k. Bullizmi
- l. Diskriminimi
- m. Diveristeti
- n. Punësimi
- o. Emigrimi
- p. Jeta kulturore
- q. Ndotja akustike
- r. Degradimi i tokës
- s. Mbipopullimi
- t. Cilësia e jetës
- u. Siguria
- v. Shërbimet sociale
- w. Turizmi
- x. Vullnetarizimi
- y. Ndotja e ujit

11. Listoni 3 problematikat kryesore në komunitetin ku ju jetoni dhe që duhet të jenë pjesë e axhendave politike të së ardhmes: *


- 1- _____
- 2- _____
- 3- _____

12. Listoni 3 problematikat kryesore të të rinjve sipas jush në Bashkinë Shijak: *

1- _____

2- _____

3- _____



Këshilli
Vendor
Rinor
Shijak